



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI" REKTORI

Njoftim për shpallje konkursi të brendshëm

Në Rektoratin e Universitetit të Elbasanit "Aleksander Xhuvani", shpallet konkurs i brendshëm, për personel ndihmësakademik me karakter administrativ. Kandidatët e interesuar, punonjës të kategorisë personel ndihmësakademik dhe administrativ, me kohë të plotë në UE, që plotësojnë kriteret e përgjithshme e të posaçme etj, në respektim të rregullores në fuqi, miratuar me Vendimit nr. 70 datë 17.11.2025 "Për miratimin e rregullores për plotësimin e vendeve të lira të punës të kategorisë personel ndihmësakademik në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" të Senatit Akademik, gjejnë informacionin e mëposhtëm:

Kategoria: personel ndihmësakademik me karakter administrativ në Bibliotekë.

Pozicioni i punës: *Bibliotekar/arkivist.*

Bibliotekar/arkivist: Zbaton procesin e modulit të qarkullimit; raporton periodikisht tek drejtori statistikatat e ecures së punës; është pjesë e procesit të punës të inventarit fizik si dhe përditësimit të inventarit elektronik; përditëson bazën elektronike të njësive bibliotekare; përgjigjet për realizimin e detyrave të ngarkuara me përpikmëri dhe nivel të lartë profesional brenda afateve; zbaton çdo urdhër të posaçëm të drejtorit për situata të veçanta, urgjente e ngjarje të rëndësishme në jetën e Insitucionit.

Kandidati duhet të plotësojë këto kriteret të përgjithshme e të posaçme:

Kriteret të përgjithshme:

- Të jetë shtetas shqiptar dhe të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi;
- të plotësojë kriteret e posaçme.

Kriteret të posaçme:

- Të ketë mbaruar studimet universitare të ciklit të parë/dytë Bachelor/Master ose ekuivalente me të, në shkencë edukimi/shoqërore. Diplomatat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura dhe njësuar nga ministria përgjegjëse për arsimin;
- Të ketë përvojë pune;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI**

- Të ketë kryer kurse apo kualifikime në fushën e arkivimit brenda/jashtë vendit.
- Të jetë njohës i një prej gjuhëve të huaja të BE-së;
- Të ketë aftësi të mira, komunikuese e të punës në grup.

Kandidatët e interesuar, në respektim të pikës **d** dhe **e** të nenit 6 “Konkursi i brendshëm” të Vendimit nr. 70 datë 17.11.2025 “Për miratimin e rregullores për plotësimin e vendeve të lira të punës të kategorisë personel ndihmësakademik në Universitetin e Elbasanit ”Aleksandër Xhuvani” të Senatit Akademik, duhet të dorëzojnë në rrugë postare në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” brenda 3 (tri) ditëve pune nga data e shpalljes në www.uniel.edu.al (02.07.2026 deri datë 06.07.2026) dokumentacionin si më poshtë:

- Letër interesi
- Dokumentacion shtesë, veç atyre që ndodhen në dosjen personale.

Dokumentacioni i kërkuar të dorëzohet në protokollin e Institucionit.

Konkursi do të zhvillohet në ambientet e Rektoratit. Komisioni ad-hoc do të vlerësojë paraprakisht kërkesat dhe dosjet e kandidatëve dhe më pas kandidatët do ti nënshtohen intervistës me gojë (07.07.2026 – 17.07.2026). Kandidatët konkurues do të njoftohen elektronikisht për rezultatet paraprake të konkurrimit, orën dhe datën e intervistës dhe për shpalljen/njoftimi i fituesit.